



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI QENDROR

URDHËR

Nr. 5, datë 21/01/2020

PËR

**ZGJATJEN E VLEFSHMËRISË SË KARTËS SË INSPEKTORIT EDHE GJATË
VITIT 2020, DERI NË RISTRUKTURIMIN E INSPEKTORATEVE
SHTETËRORE/TRUPAVE INSPEKTUESE**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 30, të Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, kreut V, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”;

U R D H Ë R O J :

1. Zgjatjen e vlefshmërisë së kartës së inspektorit të prodhuar sipas Urdhrit Nr. 32/1, datë 15.07.2016, me periudhë vlefshmërie deri më 31.12.2019, edhe gjatë vitit kalendarik 2020, deri në ristrukturimin e inspektorateve/trupave inspektuese.
2. Për çdo emërim të ri në detyrë, inspektori do të pajiset me kartën e inspektorit pranë Inspektoratit Qendror.
3. Ngarkohen Inspektorati Qendror dhe Inspektoratet Shtetërore/trupat inspektuese për zbatimin e këtij urdhri.
4. Ky urdhër dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare, publikohet në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror www.insq.gov.al, si dhe ju njoftohet inspektorateve shtetërore/trupave inspektuese.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

SHKËLQIM HAJDARI

